

KËRKESË PËR KOMPENSIM
Nr.1059, datë 12.3.2009

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.257, datë 11.4.2007 “Për kriteret dhe procedurën e kompensimit fizik me troje shtetërore, të subjekteve të shpronësuara në disa raste të veçanta”, pranë ZRKKP qarku Tiranë është paraqitur kërkesa për kompensim nga z.Kujtim Alla, përfaqësues me prokurë i trashëgimtarëve ligjorë të subjektit të shpronësuar Sabire Bogdani. Trualli i kërkuar për kompensim në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.257, datë 11.4.2007 dhe për publikim, është:

- truall me $S = 96m^2$;
- vendndodhja në rrugën “Irfan Tomini” të qytetit Tiranë (në sipërfaqen që ka shërbyer si stacioni i autobuzëve), përfshihet në zonën kadastrale nr.8220, indeks harte TR-R-7; R-8, dhe ndodhet në kufirin e sipërfaqes me nr. Pas. 6/100;
- vlera në të holla e kësaj sipërfaqeje përlllogaritet sipas zonës 7/3 të hartës përkatëse të vlerës, miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr.139, datë 13.2.2008 “Për miratimin e çmimeve të trojeve, të përcaktuara në hartat përkatëse, për qarqet e Fierit, Elbasanit, Tiranës, Vlorës, Durrësit dhe Shkodrës” (ndryshuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr.1620, datë 26.11.2008 “Për miratimin e çmimeve të trojeve që ndodhen në të gjithë bashkitë dhe në disa komuna”) me një çmim prej 26 787 m^2 (sip. 96 m^2 e kërkuar për kompensim ka një vlerë prej 2 571 552 lekë).
- Trualli përfshihet në studimin urbanistik pjesor sipas vendimit nr.312, datë 24.6.2005 të KRRT. të Bashkisë Tiranë (sipas pikës “2” të këtij vendimi, ky truall ndodhet në territorin ku ky studim hyn në fuqi pas përfundimit të procesit të privatizimit).
- Bashkëlidhur, genplani përkatës.
- Afati i paraqitjes nga subjektet të kërkesave për kompensim pranë AKKP-së, është deri në 30 ditë nga data e botimit.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM
Elvis Cefa

